UDHËZIM
Nr. 21 , datë 27.7.2022

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E "MEDALJES SË ARTË" NXËNËSVE TË SHKËLQYER NË VITE, PAS PËRFUNDIMIT TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU 1
KRITERET PËR PËRFITIMIN E "MEDALJES SË ARTË"

1. Nxënësit të shkëlqyer ndër vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, i jepet "Medalje e artë", nëse plotëson njëherësh kriteret e mëposhtme:

a) Ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00.

b) Në të gjitha provimet e Maturës Shtetërore (të detyruara dhe me zgjedhje) është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.50, nga të cilat të paktën në një provim të Maturës Shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 10.00.

c) Ka vlerësimin në sjellje "Shumë mirë", në të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë.

2. Nderohet me "Medaljen e artë" nxënësi që është fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, sipas procedurave të rregullores "Për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrja e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare".

KREU 2
PROCEDURA PËR DHËNIEN E "MEDALJES SË ARTË"

1. Në javën e parë të vitit shkollor, Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) listën emërore të nxënësve që plotësojnë kriteret sipas shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1, të kreut 1, të udhëzimit. DPAP-ja e përcjell këtë listë nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrave vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë parauniversitar (IAP).

2. Në javën e dytë të vitit shkollor, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, përgatisin dhe dërgojnë në ZVAP, listat dhe dosjet e nxënësve, që plotësojnë kriteret për "Medaljen e artë", sipas kreut 1 të këtij udhëzimi.

3. Dosja e nxënësit përmban dokumentet e mëposhtme: a) fotokopjen e kartës së identitetit; b) fotokopjen e diplomës dhe të certifikatës së Maturës Shtetërore; c) vlerësimin për sjelljen, për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë, lëshuar nga drejtoria e shkollës; d) fotokopjen e certifikatës që nxënësi ka fituar në olimpiadën ndërkombëtare, sipas pikës 2, të kreut 1, të këtij udhëzimi, nëse ai e disponon.

4. ZVAP-të përcjellin listat dhe dosjet e nxënësve në DRAP-të dhe këto të fundit i përcjellin në DPAP.

5. Në javën e tretë të vitit shkollor DPAP-ja përcjell në QSHA listën emërore të nxënësve të shoqëruar me certifikatën përkatëse, që nxënësi ka fituar në olimpiadën ndërkombëtare, sipas kritereve të pikës 2, të kreut 1, të këtij udhëzimi. QSHA-ja pasi kryen verifikimet e përcjell atë në DPAP.

6. Në javën e katërt të vitit shkollor DPAP, përcjell në MAS, listën emërore të nxënësve të verifikuar nga QSHA-ja së bashku me dosjet e nxënësve që përfitojnë "Medaljen e artë".

7. MAS-ja pasi kryen verifikimin përfundimtar të dosjes për secilin nxënës, sipas kritereve dhe procedurave të këtij udhëzimi, përcjell në Kryeministri listën e nxënësve që u jepet "Medalje e artë", të shoqëruar me projekturdhrin dhe relacionin shoqërues.

KREU 3
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. MAS-ja ka detyrimin të prodhojë "Medaljen e artë" për të gjithë nxënësit që i përfitojnë ato.

2. MAS-ja mban në një regjistër të veçantë të dhënat e nxënësve, të cilët janë pajisur me "Medaljen e artë".

3. Udhëzimi nr. 8, datë 8.4.2021, "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e 'Medaljes së artë'", i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të mesëm të lartë parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi